



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË

V E N D I M

Nr. 61, datë 09/12/2004

**“PËR
DETYRIMET FINANCIARE TË BASHKISË SË TIRANËS
NDAJ PERSONAVE TË TRETË
QË LIDHEN ME VENDIME GJYQËSORE TË FORMËS SË PRERË”**

Në mbështetje të ligjit Nr.8652, dt.31/07/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” neni 32, gërma “g” dhe “dh”, dhe në bazë të Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.16, dt.10/03/2004 “Për miratimin e realizimit të buxhetit të vitit 2003 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2004”, me propozimin e Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I;

1. Të miratojë listën dhe shumat përkatëse të detyrimeve financiare të Bashkisë së Tiranës, që lidhen me vendime gjyqësore të formës së prerë ndaj personave të tretë, sipas **Tabelës Nr.1** dhe **Nr.2** pjesë përbërëse të këtij Vendimi.
2. Efekti financiar prej 9.763.806 lekësh dhe 8.900 \$, konvertuar me kursin e ditës, sipas pikës 1 të këtij Vendimi, përballohet nga zëri “Detyrime gjyqësore” nga të ardhurat e Bashkisë së Tiranës për vitin 2004.
3. Të miratojë listën dhe shumat përkatëse të detyrimeve financiare të Institucioneve të Vartësisë, që lidhen me vendime gjyqësore të formës së prerë ndaj personave të tretë, sipas **Tabelës Nr.3** pjesë përbërëse të këtij Vendimi.
4. Efekti financiar prej 3.105.136 lekësh, sipas pikës 3 të këtij Vendimi për Institucionet e Vartësisë, të përballohen nga artikulli “Shpenzime operative” në buxhetin e miratuar për vitin 2004.
5. Shpenzimet gjyqësore dhe Taksat e Ekzekutimit sipas Tabelës Nr.1 dhe Nr.2 të përballohen nga artikulli “Shpenzime operative” të Aparatit të Bashkisë së Tiranës, sipas buxhetit të miratuar për vitin 2004.

6. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve dhe Burimeve Njerëzore dhe Drejtoria Juridike për zbatimin e Këtij Vendimi.
7. Ky Vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

K R Y E T A R I

LUAN SHAHOLLARI